



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:920229

Datë: 18.12.2020

Numri i dokumentit: 01353613

Ae.nr.339/2019

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mahir Tutuli, kryetar i kolegjit, Liridon Maloku dhe Qërim Ademaj, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit Kompania e Sigurimeve [“S...”], me seli në Luzern – Zvicër, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit [B.N], avokat nga Prishtina, kundër të paditurit “Byroja Kosovare e Sigurimeve”, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Donjeta Cakolli nga Prishtina, për shkak të regresit, në shumën e përgjithshme prej 121,729.07€, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit dhe të paditurës, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, IV.EK.nr.430/2017, të datës 10.09.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 01.12.2020 mori këtë:

A K T G J Y K I M

NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, IV.EK.nr.430/2017, të datës 10.09.2019, në pjesën aprovuese vetëm sa i përket kamatës në shumën e gjykuar ashtu që në shumën e gjykuar në lartësi prej 121,729.07€, detyrohet e paditura që paditëses t’ia paguaj kamatën sipas normës vjetore prej 8 %, duke filluar nga 06.05.2019 e deri në përmbushjen përfundimtare të borxhit, ndërsa sa i përket pjesës tjetër refuzohen si e pabazuara ankesat e paditësit dhe të paditurës dhe **VËRTETOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike IV.EK.nr.430/2017, të datës 10.09.2019.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar, e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit Kompania e Sigurimeve [“S...”], me seli në Luzern – Zvicër, ku është detyruar e paditura “Byroja Kosovare e Sigurimeve”, me seli në Prishtinë, që nga baza e regresit për pagesat e bëra në emër të shpenzimeve të trajtimit mjekësorë dhe kompensimin për shkak të paaftësisë për punë ndaj të siguruarit z. [F.K], paditësit t’ia

paguaj shumën prej 121,729.07€, me kamatë prej 12% duke llogaritur nga data e nxjerrjes së raportit të ekspertizës mjekësorë dt.06.05.2019, e deri në pagesën definitive, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi. Ndërsa në piken II të dispozitivit është detyruar e paditura që në emër të kompensimit të shpenzimeve të procedurës kontestimore paditëses t'ia paguaj shumën prej 2,593.59€, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë e paditura “Byroja Kosovare e Sigurimeve”, me seli në Prishtinë për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ankesën ta aprovoj si të bazuar, dhe ta refuzojë kërkesëpadinë e paditëses, ta ndryshojë apo ta prishë aktgjykimin IV.EK.nr.430/2017 të datës 10.09.2019 dhe lëndën ta kthej në rigjykim.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë edhe pala paditëse për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Gjykata Apelit që të miratojë ankesën e paditëses si të bazuar, dhe të ndryshojë aktgjykimin IV.EK.nr.430/2017 të datës 10.09.2019 në pjesën e cila i referohet borxhit dytësorë/kamatëvonesës, ashtu që detyrohet e paditura që paditëses në emër të rimbursimit mbi bazën e subrogimit nga rasti i siguruar i dt.06.08.2016 t'ia paguaj shumën prej 121,759.07€ me kamatëvonesën në lartësi prej 12% në vit duke filluar nga data 05.07.2017 e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e kontestit në shumën prej 3,039.59€, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës , aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së , gjeti se:

Ankesat janë të pabazuara.

Kompania e Sigurimeve [“S...“], Luzern –Zvicër, me datën 21.09.2017 ka parashtruar padi kundër të paditurës, “Byroja Kosovare e Sigurimeve”, me seli në Prishtinë , për kompensimin e dëmit-regresit të sigurimit social të pësuar nga aksidenti i komunikacionit më datën 06.08.2016, për çka ka kërkuar nga gjykata t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 91,943.30€, me kamatë ligjore prej 12% duke filluar nga data 05.07.2017, e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore. Paditësi pas nxjerrës së ekspertizës mjekësorë në fjalën përfundimtarë ka bërë precizimin e kërkesëpadisë në shumën e përgjithshme prej 121,759.07€.

Gjykata e shkallës së parë nga provat e administruara ka gjetur se me datën 06.08.2016 në Fshatin ..., ka ndodhur aksident i komunikacionit, ku të përfshira në aksident ishte automjeti i vetëm i tipit “Mercedes Benz” me numër të targave ..., të cilin e drejtonte z. [F.K] automjeti i tipit “Ford Fokus”, me numër të targave ..., të cilin e drejtonte z. [A.H] dhe automjeti i tipit Audi me numër të targave ... të cilin e drejtonte z. [E.A]. Ishte jo kontestuese në mes palëve ndërgjyqës e po ashtu është vërtetuar edhe nga raporti i ekspertizës së komunikacionit se shkaktari i aksidentit ka qenë

drejtuesi i automjetit "Ford Fokus" me numër të targave Britanike ..., gjegjësisht z. [A.H], po ashtu ishte jo kontestuese se automjeti "Ford Fokus" me numër të targave Britanike ..., ne momentin e aksidentit ka qenë i pajisur me policë sigurimi kufitare të lëshuar nga pala e paditur në procedure. Nga aksidenti lëndime trupore ka pësuar drejtuesi i automjetit "Mercedes Benz" z. [F.K] i cili fillimisht është trajtuar në Qendrën Klinike Universitare në Prishtinë, e pastaj trajtimin e ka vazhduar edhe në Zvicër ku e ka pasur vendqëndrimin e përhershëm. Padiësja ka deklaruar se ka bërë pagesa në dobi të dëmtuarit z.[F.K] dhe atë në emër të rehabilitim mjekësorë, po ashtu ka kryer pagesa edhe për shkak të paaftësisë për punë. Si rezultat i aksidentit të ndodhur z. K nga data e aksidentit e deri me datën 06.08.2017 ka qenë i paafte për punë në shkallën prej 100% ndërsa nga data 06.08.2017 e deri më datën 31.08.2018 ka qenë i paafte për punë në shkallën prej 50%. Pala e paditur e ka konstatuar kërkesën e palës paditëse me pretendimin se ndërmjet lëndimeve trupore dhe aksidentit të ndodhur nuk është vërtetuar lidhja kauzale, po ashtu ka theksuar se z. K ka mundur që të trajtohet në Kosovë, me shpenzime me të vogla.

Për përcaktimin dhe vlerësimin e shkallës së lëndime trupore dhe lidhjes kauzale në mes aksidentit dhe lëndime trupore të z. [F.K], gjykata e shkallës së parë, ka angazhuar ekspert nga lëmia mjekësore. Nga raporti i ekspertizës së ekspertit mjekësorë Dr. [A.T] ka rezultuar se si pasojë e aksidentit të ndodhur z.[F.K] ka marrë lëndime trupore dhe se lëndimet e marra janë në lidhje kauzale me aksidentin e ndodhur. Si pasojë e lëndimeve të marra në aksident ka pësuar zvogëlim të përkohshëm të paftësisë se tij punuese dhe atë për paftësi të përkohshme për punë në shkallën prej 100%, për përudhën prej datës së aksidentit 06.08.2016 e deri me datën 06.08.2017, kjo për faktin e mbajtjes në imobilizim për 12 javë, dhimbjeve të mëdha në ecje me ndihmën e kukëzave dhe procedurave të rehabilitim fizikal. Paftësi të përkohshme për punë në shkallën prej 50% në periudhën prej datës 07.08.2017 e deri me datën 21.08.2018. Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se raporti i ekspertit mjekësorë i punuar nga eksperti [A.T] është punuar në mënyrë profesionale, është në përputhje me provat e tjera të lëndës, si dhe është arsyetuar në masë të mjaftueshme, andaj të njëjtit i është falur besimi në lidhje me shkallën e dëmtimeve të shkaktuar dhe paftësinë përkohshme për punë.

Gjykata e shkallës së parë nga provat e shqyrtuar në këtë çështje juridikë siç është listingu i pagesave ka gjetur se paditësi ka bërë kompensimin e shpenzimeve të mjekimit për të dëmtuarin [F.K] duke kryer pagesa në emër të trajtimit mjekësorë deri me datën 21.08.2018 në shumën e përgjithshmen prej 79,160.05 CHF. Po ashtu në emër të paftësisë për punë për periudhën prej datës 06.08.2016 e deri me datën 21.08.2018 pala paditëse në dobi të siguruarit të tij ka kryer pagesa. Pala paditëse ka zbritur kërkesat për rimbursim në emër të pagesave për paftësi për punë në shumën prej 56,268.00 CHF, duke e bërë harmonizimin e pagesave me konstatimet e ekspertit mjekësorë, prandaj gjykata e shkallës së parë ka ardhur në përfundim se shuma e përgjithshme e pagesave të cilat paditësi ka qenë i detyruar nga baza e sigurimit social që t'ia paguaj të siguruarit të tij në shumën prej 135,428.05 CHF, apo në shumën prej 121,759.07€.

Bazuar ne gjetjet e sipërcekura, gjykata e shkallës së parë duke u mbështetur në dispozitat e nenit 960 paragrafi 1 të LMD-së, si dhe në dispozitën e nenit 452 par.1 të LPK-se, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale respektivisht nenin 960 paragrafi 1 i LMD-së, sipas të cilit " *me pagimin e kompensimit nga sigurimi kalojnë në siguruesin, në bazë të vetë ligjit, deri në shumën e kompensimit të paguar, të gjitha të drejtat e të siguruarit ndaj personit i cili mbi cilën bazë qoftë është përgjegjës për dëm*". Ndërsa me nenin 3 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga auto përgjegjësia është përcaktuar se " *siguruesi është përgjegjës për kompensimin e dëmeve të shkaktuara personave të trete, nga përdorimi i automjetit të siguruar mbi bazën e auto përgjegjësive. Në rastin konkret nga shkresat e lëndës, rezulton se në aksidentin e trafikut të datës 06.08.2016, lëndime trupore kishte pësuar z. [F.K]. Padiësi mbi bazën e sigurimit social të detyruar në Zvicër, i ka paguar shpenzimet e trajtimit mjekësor e po ashtu ka kryer edhe pagesa në emër të paaftësisë së përkohshme punuese. Në lidhje me trajtimin mjekësorë ia ka kompensuar shumën prej 79,160.05 CHF. Po ashtu në emër të paaftësisë për punë për periudhën prej datës 06.08.2016 e deri me datën 21.08.2018 pala padiëse në dobi të siguruarit të tij ka kryer pagesa, ku pala padiëse ka zbritur kërkesat për rimbursim në emër të pagesave për paaftësi për punë në shumën prej 56,268.00 CHF, respektivisht shumën e përgjithshëm prej 135,428.05 CHF. Prandaj, kjo gjykatë vlerëson se shumica e pagesave të cilat padiësi ka qenë i detyruar nga baza e sigurimit social që t'ia paguaj të siguruarit të tij është në shumën prej 135,428.05 CHF, apo në shumën prej 121,759.07€.*

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe pretendimet tjera ankimore të palëve por gjeti se te njëjta janë ta pabazuara dhe në kundërshtim me vet qëndrimin e procedurës së zhvilluar pranë gjykatës së shkallës së parë. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, është plotësisht i pabazuar pretendimi ankimor për vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike sepse nga shkresat e lëndës rezulton se gjykata e shkallës së parë ka administruar të gjitha provat në dispozicion dhe ka shfrytëzuar të gjitha mjetet provuese për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike dhe me të drejtë caktimin e lartësisë së kompensimit e ka bazuar në konstatimet e ekspertit mjekësor të dhëna në ekspertizën e datës 06.05.2019, listingu i pagesave të datës 28.08.2017, ndërsa këto konstatime përputhen me provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Gjykata Apelit i vlerësoi edhe pretendimet ankimore të palës së paditur lidhur me atë së shpenzimet e trajtimit mjekësorë që i janë dhënë të dëmtuarit nga padiësja a kanë mundur të ofrohen në Kosovë me shpenzime me të vogla, dhe faktin se a ka pasur rekomandim nga institucionet shëndetësore të Kosovës për trajtim jashtë vendit, mirëpo kjo gjykatë i vlerësoi si të pabazuar ngase i dëmtuari në aksident z.[F.K] ka qenë më vendqëndrim të përhershëm në shtetin e Zvicrës dhe po ashtu ka qenë në marrëdhënie punë në shtetin e Zvicrës, andaj shërimi i tij në vendqëndrimin e tij është i arsyeshëm. Po ashtu kjo gjykatë i vlerëson si të pabazuar edhe pretendimet ankimore të palës së paditure lidhur me atë se lëndimet nuk janë në lidhje direkt me aksidentin e ndodhur, mirëpo duke ju referuar raportit të ekspertizës mjekësorë është vërtetuar se lëndimet trupore janë në lidhje direkt me aksidentin e ndodhur, dhe se të gjitha procedurat në lidhje me trajtimin mjekësorë të lënduarit janë kryer me rregull.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërshtim me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen

faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata e Apelit.

Mirëpo, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë lidhur me pjesën që ka të bëjë me kamatën e gjykuar përfshihet me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale nga neni 382 LMD-së (nr.04/L-077), dhe lidhje me nenin 26.7 të Ligjit për sigurinë e detyrueshëm nga auto përgjegjësia nr. (04/L-018 e cila ka hyrë në fuqi më 30 korrik 2011).

Zbatimi i gabuar i të drejtës materiale qëndron në faktet se, kamata e aprovuar nga gjykata e shkallës së parë, ligjërisht nuk aplikohet në kontestet për regresim të borxhit por vetëm në kërkesat e trajtimit të kërkesave të personave të dëmtuar për shpërblim të dëmit në procedurën jashtëgjyqësore ashtu siç parashihet në nenin 26 të Ligjit Ligji për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia, në të cilat dispozita thirret gjykata e shkallës së parë. Kamata e aplikuar nga gjykata e shkallës së parë është paraparë me qëllim të disiplinimit të kompanive siguruese në raportet e sigurimit ndaj kërkesave për dëmshpërblim të personave të dëmtuar të cilat kërkesa kompanitë e sigurimeve janë të detyruara që t'i trajtojnë me urgjencë brena afateve të parapara sipas dispozitave të lartpërmendura.

Paragrafi 7, i nenit 26 të Ligjit për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia, përjashton zbatimin e kamatës prej 12% për regresim borxhi, kamatë kjo e paraparë vetëm për mostrajtim dhe rënien në vonesë të trajtimit të kërkesave të personave të dëmtuar për dëmshpërblim. Nga kjo rezulton se paditësi ka të drejtë vetëm në kamatëvonesë të paraparë me nenin 382 të LMD-së, por jo edhe kamatë "të kualifikuar" sipas dispozitave të zbatuara nga gjykata e shkallës së parë.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 201 pika d) të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS,
Ae.nr.339/2019, dt. 01.12.2020

KRYETARI I KOLEGJIT,

Mahir Tuti, d.v.

